

Pasqyrat Financiare dhe Raporti i Auditorit të pavarur

Fondi Slloveno Kosovar i Pensioneve – Fondi 1

31 Dhjetor 2012

Përmbajtja

	Faqe
Pasqyra e Aseteve Neto të Fondit 1	5
Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve	6
Pasqyra e ndryshimeve në asetet neto të fondit	7
Indikatorët financiar të njësive të llogaritjes	8
Pasqyra e njësive kontabël	9
Shënimet e pasqyrave financiare	10

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Menaxhmentin dhe Themeluesit e Fondit Slloveno Kosovar të Pensioneve - Fondi 1

Ne kemi audituar pasqyrat financiare përcjellëse të Fondit Slloveno Kosovar të Pensioneve - Fondi 1 (më tej referuar si "Fondi 1") për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012, që përbëhet nga Pasqyra e Aseteve Neto të Fondit, Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzimeve, Pasqyra e Ndryshimeve në Asetet Neto të Fondit 1, Indikatorët Financiar të Njësive Llogaritës, si dhe një përmbledhje të politikave kryesore kontabël dhe shënime tjera shpjeguese.

Përgjegjësite e menaxhmentit për pasqyrat financiare

Manaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezentimin e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në pajtueshmëri me rregulloret e përcaktuara nga Banka Qëndrore e Kosovës të zbatueshme për fondet pensionale ("Rregullat e BQK-së") në Kosovë, siq është dhënë në shënimin 2 dhe për këte menaxhmenti përcakton kontrollet e brendshme të nevojshme të mundësojë përgaditjen dhe paraqitjen e pasqyrave financiare pa anomali materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësi e jona është të japim një mendim në këto pasqyra financiare bazuar në auditimin tonë. Ne zhvilluam auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat etike dhe planifikojmë e zhvillojmë auditimin për të arritur siguri të arsyeshme mbi atë se a janë pasqyrat financiare të liruara nga gabimet materiale.

Auditimi përfshinë zbatimin e procedurave që të arrijmë dëshmi audituese rreth shumave dhe shpalosjeve në pasqyrat financiare. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë vlerësimin e riskut të gabimeve materiale të pasqyrave financiare, qoftë nga gabimi apo mashtrimi. Në bërjen e këtyre vlerësimeve të riskut, auditori merr në konsiderim kontrollin e brendshëm relevant për përgaditjen dhe prezentimin e drejtë të pasqyrave financiare të entitetit në mënyrë që të dizajnoj procedurat e auditimit që janë të duhura për rrethanat, por jo për qëllim të dhënies së një mendimi mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të entitetit. Auditimi gjithashtu përfshin vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave të kontabilitetit të përdorura dhe arsyeshmëria e vlerësimeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezentimit të përgjithshëm të pasqyrave financiare.

Ne besojmë që dëshmia audituese që kemi siguruar është e mjaftueshme dhe e duhur që të ofrojë bazë për mendimin tonë të kualifikuar të auditorit.

Bazat për Mendim të Kualifikuar

Siq është shpalosur në shënimin 6 të pasqyrave financiare, Fondi 1 ka prezentuar letrat me vlerë të mbajtura deri në maturitet që arrijnë shumën EUR 4,169,523 më 31 Dhjetor 2012 (2011: Euro 3,882,745). Ka pasur indikacion për dëme për disa prej asetëve të cilave më 31 Dhjetor 2012 çmimet vëzhguese të tregut ishin dukshëm më të ulëta se shuma nominale e letrave me vlerë përkatëse. Fondi 1 nuk ka regjistruar ndonjë provision për dëme të këtyre letrave me vlerë të mbajtura deri në maturitet të cilat, në gjykimin tonë duhet të arrijnë në Euro 123,468. Përveç kësaj, auditori paraardhës kishte një kualifikim të ngjajshëm në vitin raportin e auditimit të vitit 2011 sa i përket letrave me vlerë Greke për të cilat, sipas mendimit të tyre, një provision dëmtimi në shumë prej 63,210 duhet të ketë qenë llogaritur. Letrat me vlerë Greke janë shlyer më vonë për të reflektuar vlerën e tyre pas ristrukturimit të borxhit grek dhe dëmtimit të rezultuar in 2012 që arriti në Euro 50,422. Prandaj, letrat me vlerë të mbajtura deri në maturitet deri në Dhjetor 2012 dhe 2011 janë mbivlersuar për Euro 123,468 më 31 Dhjetor 2012 dhe për Euro 63,210 më 31 Dhjetor 2011 dhe teprica neto për dy vitet ishte mbivlersuar në përputhje me rrethanat.

Mendim i kualifikuar

Sipas mendimit tonë, përveç ndikimeve të çështjeve të përshkruara në paragrafin Bazat për Mendim të Kualifikuar, pasqyrat financiare të Fondit 1 janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në përputhshmëri me Rregullat e BQK-së siq janë dhënë në shënimin 2 të pasqyrave financiare.

Çështjet Tjera

Pasqyrat financiare të Fondit 1 për fundvitin 31 Dhjetor 2011 janë audituar nga një auditorë i cili ka shprehur një opinion të kualifikuar për ato pasqyra më 11 Prill 2012 në lidhje me dëmtimin e letrave me vlerë qeveritare që nuk janë njohur në pasqyrat financiare.

Ernst & Young Certified Auditors Ltd, Prishtinë

Prishtinë, 12 Prill, 2013

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Pasqyra e Aseteve Neto të Fondit 1

	Shënime	2012	(në Euro) Më 31 Dhjetor 2011
Asetet			
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	4	101,046	77,919
Letrat me vlerë të mbajtura për tregëtim	5	196,768	117,263
Investimet të mbajtura deri në maturitet	6	4,169,523	3,882,745
Të arkëtueshmet tjera		387	1,748
Total asete		4,467,724	4,079,675
Detyrimet dhe fondet e pjesëmarrësve			
Detyrimet			
Detyrimet për tarifën e menaxhimit		6,741	17,137
Të pagueshmet për pension të pjesëmarrësve		-	16,806
Detyrime të tjera	7	10,183	182
Total i detyrimeve		16,924	34,125
Fondet e pjesëmarrësve			
Asetet neto të Fondit 1		4,307,212	3,897,623
Teprica për vit		143,588	147,927
Totali i fondeve të pjesëmarrësve		4,450,800	4,045,550
Total detyrimet dhe fondet e pjesëmarrësve		4,467,724	4,079,675
Njësitet e llogaritjes të emtuara		34,243.9774	32,194.5783
Vlera e njësisë së llogaritjes		129.9732	125.6594

Keto pasqyra financiare janë aprovuar nga Menaxhmenti i Fondit Slloveno Kosovar të Pensioneve – Fondi 1 më 22 Mars, 2013 dhe janë nënshkruar në emër të,

Mr. Bajram Bajrami
Drejtore menaxhues

Pasqyrat Financiare duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura nga faqet 8 deri 21, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve

	Shënime	(në Euro)	
		Viti i përfunduar më 31 Dhjetor 2012	2011
Të ardhurat nga interesi	8	150,673	142,872
Të hyrat e dividendëve		3,190	1,927
Të hyrat të tjera		13	73
Totali i të ardhurave		153,876	144,872
Shpenzimet			
Tarifa e menaxhimit		(63,715)	(57,948)
Humbjet e realizuara nga investimet në letrat me vlerë		(50,422)	-
Tarifa e provizionit dhe transaksioneve		(5,575)	(2,760)
Total shpenzimet		119,712	(60,708)
Neto fitimi nga investimet		34,164	84,164
Fitimet e perealizuara			
Fitimet e perealizuara/(humbjet) nga letrat me vlerë të mbajtura për tregëtim, neto		19,613	(30,170)
Amortizimi i zbritjes së letrave me vlerë me maturitet fiks		93,043	86,464
Ndryshimet e këmbimit në valutë të huaj nga investimet në letrat me vlerë		(3,231)	7,469
Total fitime të perealizuara		109,424	63,763
Teprica neto e Fondit 1 për vitin		143,588	147,927

Pasqyrat Financiare duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura nga faqet 8 deri 21, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Pasqyra e Ndryshimeve në Asetet Neto të Fondit 1

	(në Euro)	
	Viti i përfunduar më 31 Dhjetor 2012	2011
Fitimi neto nga investimet	33,637	84,164
Fitimet e porealizuara	109,424	63,763
Teprica neto e Fondit 1 për vitin	143,588	147,927
Kontributet e pjesmarrësve që janë pranuar	369,791	425,371
Pensionet e paguara	(108,129)	(138,730)
Rritja ne njësi llogarites	261,662	286,641
Total rritja në asetet neto	405,250	434,568
Asetet neto më 01 Janar	4,045,550	3,610,982
Asetet neto më 31 Dhjetor	4,450,800	4,045,550
Numri i njësive llogaritëse të emetuara	2,049.3991	2,329.0896

Pasqyrat Financiare duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura nga faqet 8 deri 21, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Indikatorët Financiar të Njësive Llogaritës

	(në Euro)	
	Viti i përfunduar më 31 Dhjetor 2012	2011
Njësitet llogaritës në fillim të vitit	32,194.5783	29,865.4887
Vlera e njësive llogaritës në fillim të vitit	125.6594	120.9082
Asetet neto të fondit të pensioneve në fund të vitit	4,450,800	4,045,550
Numri i njësive llogaritëse në fund të vitit	34,243.9774	32,194.5783
Vlera e njësive llogaritëse në fund të vitit	129.9732	125.6594

Pasqyrat Financiare duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura nga faqet 8 deri 21, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare

Pasqyrat Financiare
31 Dhjetor 2012

Pasqyrat e njësive llogaritës

	(në Euro)	
	Viti i përfunduar më 31 Dhjetor 2012	
Përshkrimi	Numri i njësive të llogaritjes	Vlera e asetëve neto
Njësitë llogaritës në fillim të vitit	32,212.504	3,628.003
Njësitë llogaritës të emetuar gjatë vitit - kontributet	2,900.8593	369.792
Njësitë llogaritës të emetuar gjatë vitit – transferet në fondet tjera	-	-
Reduktimi i njësive llogaritës për shkak të transfereve në fondet tjera	-	-
Reduktimi i njësive llogaritës për shkak të pagesave të benefiteve	(851.4602)	(108,129)
Reduktimi i njësive llogaritës për shkak të pagesës së tarifës nga asetet neto të Fundit 1	-	-
Rritja (zvoglimi) neto nga operacionet	143,061	147,927
Gjithsej numri i njësive llogaritës në fund të vitit	34,243.9774	4,450,800
Vlera e njësisë së llogaritjes		
Në fillim të vitit		125,6594
Në fund të vitit		129,9732

Pasqyrat Financiare duhet lexuar së bashku me shënimet e paraqitura nga faqet 8 deri 21, duke formuar një pjesë integrale të pasqyrave financiare

Shënimet e pasqyrave financiare

1 E përgjithshme

Fondi Sllloveno Kosovar i Pensioneve Sh.a. (më tej referuar si “Kompania” ose “FSKP”) është themeluar si asociacion i aksionarëve më 4 Shtator 2006 duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-084 për ndryshimin e Rregullores së UNMIK-ut 2005/20 mbi Pensionet në Kosovë.

Ligji nr. 03/L-084 për ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut 2005/20 mbi pensionet në Kosovë nën të cilin është themeluar Fondi Sllloveno Kosovar i Pensioneve – Fondi 1, parashikon mbi programin suplementar e kursimeve pensionale , të themeluar nga kontributet pensionale të të punësuarit dhe punëdhënësit. Secili pjesmarrës vullnetar ka Llogarinë Individuale në Fondin 1, në të cilën kreditohen kontributet.

Fondi 1 administrohet dhe menaxhohet nga Kompania – FSKP, që ndodhet në rr. UÇK nr 50/2, 10000 Prishtinë, Republika e Kosovës.

2 Politikat kontabël

Në vazhdim janë paraqitur politikat kryesore të kontabilitetit të adoptuara në përgatitjen e këtyre pasqyrave financiare.

2.1 Bazat e përgatitjes

Këto pasqyra financiare janë përgatitur në përputhshmëri me rregullat dhe rregulloret e Bankës Qëndrore të Republikës së Kosovës të cilat zbatohen për fondet pensionale (“Rregullat e BQK-së”) dhe në veçanti, bazuar në vendimin relevant ligjor i cili definon zbatimin e detyrueshëm të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (“SNRF”), në Kosovë. Këto pasqyra financiare duhet të lexohen ashtu siq janë përgatitur në përputhshmëri me standardet dhe rregulloret kontabël që mbizotërojnë në Kosovë, duke iu referuar politikave kontabël të vëna më poshtë, dhe nuk duhet të lexohen ose konsiderohen si pasqyra financiare të pregaditura në përputhshmëri me SNRF.

2.2 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

Paraja dhe ekuivalentet e parasë, përfshijnë balancat me bankat për pagesat e kontribuesve pensional si dhe për qëllime të investimeve, barten në kosto.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveç nëse është e theksuar ndryshe)

2.3 Asetet financiare

Fondi 1 i klasifikon asetet financiare në kategoritë në vazhdim: në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes, huatë dhe të arkëtueshmet, të mbajtura për maturim dhe të gatshme për shitje. Klasifikimi varet nga qëllimi për të cilin asetet financiare janë përvetësuar. Menaxhmenti përcakton klasifikimin e aseteve financiare në njohjen fillestare.

Asetet financiare me vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes

Asetet financiare në vlerë të përmes fitimit ose humbjes janë asetet financiare të mbajtura për tregëtim dhe ato të përcaktuara në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes në fillim. Aseti financiar klasifikohet në këtë kategori nëse kërkohet kryesisht për qëllime të shitjes në periudhë afatshkurtër ose nëse është e përcaktuar ashtu nga menaxhmenti. Asetet në këtë kategori klasifikohen si asete qarkulluese.

Huatë dhe të arkëtueshmet

Huatë dhe të arkëtueshmet janë asete financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktuara që nuk janë kuotuar në tregun aktiv. Ato janë të përfshira në asete qarkulluese, përveç për maturitet më të gjatë se 12 muaj pas datës së bilancit të gjendjes. Këto klasifikohen si asete jo-qarkulluese.

Asetet financiare të gatshme për shitje

Asetet financiare të gatshme për shitje janë asete jo-derivative që ose janë përcaktuar në këtë kategori ose nuk janë klasifikuar në ndonjë kategori tjetër. Janë të përfshira në asetet jo-qarkulluese përveç nëse menaxhmenti ka ndërmend ti heqë investimet brenda 12 muajve nga data e bilancit të gjendjes. Fondi 1 nuk ka asete të klasifikuara në këte kategori.

Asetet financiare të mbajtura deri në maturitet

Investimet e mbajtura deri në maturitet janë asete financiare jo-derivative me pagesa fikse ose të përcaktueshme dhe me maturitete fikse që menaxhmenti i Fondit 1 ka qëllim pozitiv dhe aftësi ti mbaj deri në maturitet. Kur Fondi 1 ka ndërmend të shesë përveç ndonjë shume të vogël të aseteve të mbajtura deri në maturitet, e tërë kategoria do të priset dhe do të riklasifikohet si të mbajtura për tregëtim.

Njohja fillestare, matja dhe mosnjohja

Blerjet dhe shitjet e rregullta të aseteve financiare njihen në datën e tregëtimit – data në të cilën Fondi 1 zotohet të blejë apo shesë asetin. Investimet fillimisht janë njohur në vlerën reale plus kostoja e transaksionit për të gjitha asetet financiare që nuk janë bartur në vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes.

Asetet financiare të bartura në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes fillimisht janë njohur në vlerën e drejtë dhe kostot e transaksionit janë shpenzuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Asetet financiare janë hequr kur e drejta për të pranuar rrjedhë të parase nga investimet ka skaduar ose është transferuar dhe Fondi 1 ka transferuar kryesisht të gjitha risqet dhe shpërblimet e pronësisë.

Asetet financiare të gatshme për shitje dhe asetet financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes janë bartur më pas në vlerë reale. Huatë dhe të arkëtueshmet janë bartur në kosto të amortizuar duke përdorur metodën e interes efektiv. Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturitet janë njehësuar në kosto të amortizuar duke përdorur metodën e normës efektive të interes. Të hyrat e perealizuara të interes dhe amortizimi i zbritjes/(primit) janë njohur si e hyrë dhe shpenzim për periudhën.

Fitimet dividente dhe fitimet apo humbjet nga ndryshimet në vlerën e drejtë të kategorisë së “aseteve financiare në vlerë të drejtë përmes fitimit ose humbjes” janë njohur si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve në periudhën në të cilën ato rrjedhin.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveç nëse është e theksuar ndryshe)

Asete financiare (vazhdim)

Ndryshimet në vlerën e drejtë të letrave me vlerë momentare dhe jo-momentare të klasifikuara si të gatshme për shitje janë njohur në ekuitet. Kur letrat me vlerë të klasifikuara si të gatshme për shitje janë shitur ose dëmtuar, rregullimet e vlerës së drejtë të akumuluar që janë njohur në ekuitet janë përfshirë në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si "fitim apo humbje nga letrat me vlerë të investimit."

Interesi mbi letrat me vlerë të gatshme për shitje i llogaritur duke përdorur metodën e interesit efektiv është njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si pjesë e të ardhurave të tjera. Dividentët mbi instrumentët e ekuitetit të gatshme për shitje janë njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve si pjesë e të hyrave tjera kur është përcaktuar e drejta e Fondit 1 për të pranuar pagesat.

Vlerat reale të investimeve të kuotuar janë bazuar në çmimet aktuale të ofertimit. Nëse tregu për një asset financiar nuk është aktiv (dhe për letra me vlerë të pa listuara), Fondi 1 përcakton vlerën reale duke përdorur teknikat e vlerësimit.

Dëmtimi i aseteve financiare

Fondi 1 vlerëson në secilën datë të bilancit nëse ka dëshmi objektive se një asset financiar ose grup i aseteve financiare janë dëmtuar. Në rastin e letrave me vlerë të ekuitetit të klasifikuara si të gatshme për shitje, një rënie e rëndësishme ose e tejzgjatur në vlerën reale të letrës me vlerën nën koston e saj konsiderohet si indikator se është dëmtuar. Nëse një dëshmi e tillë ekziston për asetet financiare të gatshme për shitje, humbja kumulative – e matur si ndryshim ndërmjet çmimit të përvetësimit dhe vlerës reale aktuale, minus provizioni për humbjen e dëmit mbi asetin financiar më parë të njohur në fitim dhe humbje – është hequr nga ekuiteti dhe njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Humbjet e dëmtimeve të njohura në pasqyrën e të ardhurave tek instrumentët e ekuitetit nuk janë kthyer përmes pasqyrës së të ardhurave. Testimi i dëmtimit të arkëtueshmeve tregtare është përshkruar më tej në këtë shënim.

2.4 Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet e ndërlidhura me letrat me vlerë të investimit

Të arkëtueshmet dhe të pagueshmet që dalin nga përvetësimi dhe shitja e letrave me vlerë janë njohur si asete dhe/ose detyrime në datën kur është kryer transaksioni. Ato shlyhen në datën e pagesës.

2.5 Asetet e Fondit 1 dhe strategjia e investimit

Fondi 1 është i obliguar të ndjekë rregullat e BQK-së në lidhje me investimet në lloje të ndryshme të aseteve financiare dhe shumat e investimeve në këto asete.

Siq përshkruhet nga Rregulla 9 mbi Investimet e Aseteve Pensionale, pasuese e dispozitave të Ligjit nr. 03/L-084 mbi ndryshimin e rregullores së UNMIK-ut nr. 2005/20, Fondi 1 duhet të përmbushë kushtet e përgjithshme në vazhdim:

- a. Fondi duhet të investojë asetet e tij vetëm në klasët e investimeve të lejuara (të pranueshme) të parashikuara sipas kësaj rregulle ose në para të deponuara te kujdestari ose për paratë dhe depozitat bankare që paraqesin shumat që janë arsyeshëm të nevojshme për të zhvilluar operimet e tij pensionale.
- b. Pranueshmëria e investimit përcaktohet në kohën e blerjes së tij ose përvetësimit. Nëse përcaktimi i pranueshmërisë është i bazuar në shumën, kufizimi bazohet në shumën e totalit të aseteve të investimit sipas datës së fundit të vlersimit të aseteve, që është raportuar në BQK.
- c. Investimet e aseteve pensionale duhet të jenë në pajtueshmëri me deklaratën e parimeve të investimeve dhe konform me direktivat e investimit të përshtatura dhe të lëshuara nga entiteti i pensionit në pajtim me kërkesat e Rregullores së Pensioneve dhe këto Rregulla.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveç nëse është e theksuar ndryshe)

Asetet e Fondit 1 dhe strategjia e investimit (vazhdim)

Investimet e bëra duke thyer dhe shkelur parimet dhe direktivat e investimit duhet të përmirësohen menjëherë. Shkeljet dhe devijimet, të investimeve të mëparshme të konfirmuara, që vijnë nga shkak ose shkaqet përtej kontrollit të bordit të drejtorëve ose menaxherit të aseteve pensionale mund të përmirësohen për një kohë të tillë dhe mënyrë që është më pak e dëmshme për interesin e pjesëmarrësve ku periudha kohore nuk është më shumë se 6 muaj nga data e shkeljes apo devijimit.

- d. Organet drejtuese të entiteteve pensionale që sigurojnë pensione duhet të dorëzojnë në BQK së bashku me raportet tremujore dhe vjetore, deklaratën e vërtetuar nga një zyrtar i autorizuar, duke vërtetuar se të gjitha asetet e investuara të entitetit janë në pajtueshmëri me kushtet, ndalesat dhe kufizimet e parashtruara në Rregulloren e Pensioneve dhe në këtë rregull dhe konform deklaratës së parimeve të investimit dhe direktivat e investimit të adoptuara nga entiteti; duke siguruar se, nëse ndryshe, deklarata e vërtetuar duhet qartë të tregojë natyrën e kundërvajtjes, shkeljes ose devijimit, duke identifikuar veqanërisht investimet e aseteve jo në pajtueshmëri dhe duke përshkruar mënyrën dhe afatin kohor dhe/ose përmirësimin.

Siq këshillohet nga Rregulla 9, Fondi 1 duhet të ndjekë dhe të përmbushë kushtet specifike në vazhdim:

- a. Në çdo kohë, investimet e aseteve pensionale janë temë e kushteve specifike në vazhdim:
- Fondet apo aksionet e ekuitetit nuk duhet të jenë më të mëdha se 5 % e totalit të aksioneve të emetuara nga një emetues.
 - Obligimet nuk duhet të jenë më të larta se 30% të qfarëdo emetimi të vetëm të obligacionit.
 - Investimet totale në çdo entitet, përfshirë edhe entitetin e tij të bashkuar, nuk duhet të jetë më i lartë se 5% të totalit të aseteve pensionale.
- b. Për mbrojtje të mëtutjeshme të kualitetit të aseteve pensionale, BQK kohë pas kohe mund të këshillojë shkallët minimale të investimit ose klasifikimit të letrave me vlerë në përcaktimin e pranueshmërisë së investimit. Shkalla e investimit ose kushtet e klasifikimit do të formojnë dhe bëjnë pjesë në këtë Rregull në datën e rregulluar me direktivat me shkrim nga BQK-ja që përshkruajnë kërkes(at) e tilla.

Letrat me vlerë të cilat janë të pranueshme (të lejuara) janë në vazhdim:

A Letrat me vlerë të emetuara dhe/ose të lokalizuara jashtë Kosovës

Asetet pensionale mund të investohen vetëm në llojet ndërkombëtare dhe klasat si në vazhdim:

- Fondet monetare, përfshirë llogaritë bankare dhe depozitat me banka që janë të licensuara nga autoriteti rregullativ banker i një shteti anëtar i OECD-së, dhe licenca e të cilit mbetet në fuqi dhe gjendje të mirë.
- Letrat me vlerë të lëshuara nga ndonjë shtet anëtar i OECD-së.
- Letrat me vlerë të lëshuara nga qeveritë vendore në shtetet anëtare të OECD-së në atë masë që të jenë të garantuara nga shteti përkatës.
- Letrat me vlerë të regjistruara me rregullatorin e tregjeve kapitale të ndonjë shteti anëtar te OECD-së dhe të vendosura për ofertë publike dhe aktivisht të listuara dhe tregtuara në Bursën e Aksioneve që në shtetet e tilla është rregulluar dhe mbikqyre në mënyrë përkatëse.
- Letrat me vlerë të ndërsjellta ose fondet tjera të investimeve (open end entities) në lidhje me aprovimin e shteteve anëtare të OECD-së për themelimin e tyre dhe për përshtatshmërinë të cilave kërkesat janë parashikuar nga autoriteti përkatës rregullator dhe mbikqyrës Brenda shteteve të tilla anëtare në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve të biznesit të entiteteve të tilla “open-end”.
- Të gjitha llojet dhe klasat e letrave me vlerë ndërkombëtare që mund të autorizohen, kohë pas kohe, nga ligjet, statutet, rregulloret dhe rregulla efektive të lëshuara nga autoritetet kompetente në Republikën e Kosovës.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveç nëse është e theksuar ndryshe)

Asetet e Fondit 1 dhe strategjia e investimit (vazhdim)

B Letrat me vlerë të lëshuara dhe/ose të lokalizuara në Republikën e Kosovës

- Fondet Monetare, duke përfshirë llogari bankare dhe depozitat në banka që janë të licensuara nga BQK dhe që zhvillojnë biznes ndërkombëtarë në Republikën e Kosovës në raport të mirë me kërkesat rregullative të BQK-së.
- Letrat me vlerë të lëshuara nga autoriteti kompetent në republikën e Kosovës, në shtrirje të garantuar nga autoriteti i tillë.
- Letrat me vlerë të lëshuara nga ndërmarrjet publike dhe/ose private që janë regjistruar në rregullatorin e tregjeve kapitale në Kosovë duke siguruar se fondet e tilla janë të listuara dhe tregtuar në bursën(at) e letrave me vlerë të listuara në republikën e Kosovës ose në një vend anëtar të OECD-së dhe që janë subjekt të rregullimit dhe mbikqyrjes nga autoriteti i tregut kapital në atë shtet.
- Fondet e ndërsjellta dhe fondet e tjera të ndërsjellta (entitet open-end) që janë subjekte të aprovimit në Kosovë dhe për të cilat kërkesat e përshtatshmërisë janë përshkruar nga autoriteti rregullator dhe mbikqyrës përkatës në Republikën e Kosovës në lidhje me zhvillimin e aktiviteteve biznesore të entiteteve të tilla open-end.
- Të gjitha llojet tjera dhe klasët e letrave me vlerë vendore që mund të autorizohen, kohë pas kohe, nga ligjet, statutet, rregulloret dhe rregullat efektive të lëshuara nga autoritetet kompetente në Republikën e Kosovës.

Fondi 1 duhet gjithashtu të jetë në pajtueshmëri me rregullën mbi **investimet e ndaluara** të cilat definojnë si më poshtë:

Asetet pensionale nuk mund të investohen në llojet në vazhdim:

- Letrat me vlerë që nuk janë të listuara ose që nuk janë të tregtuara publikisht.
- Asetet të cilat nuk mundën ligjërisht të barten, shiten, hiqen ose në mënyrë tjetër të tjetërsohen.
- Letrat me vlerë derivative, opsionet, pritishtëritë, të përshtatshmet dhe marrëveshjet tjera në lidhje me letrat me vlerë dhe asetet tjera financiare.
- Asetet e patundshme ose materiale që nuk janë të listuaranë tregje të organizuara për të cilat vlerësimi është i pasigurtë duke përfshirë, por duke mos qenë i kufizuar për objektet me vlerë, punimet e artit, antikitetet, monedhat, koleksionet, dhe automjetet.
- Letrat me vlerë të lëshuara nga palët e përshkruara siq janë definuar në këtë Rregull.
- Letrat me vlerë të llojeve që nuk janë të lejuara me rregulloren e pensioneve, këtë rregull dhe/ose letrat me vlerë të siguruara e që nuk janë në pajtim me principet e investimit dhe direktivat e entitetit të pensionit në kohën e përvetësimit të tyre.
- Të tjera asete dhe letrat me vlerë të tilla siq janë specifikuar nga SRSG dhe/ose ligjet, statutet, rregulloret dhe rregullat e nxjerra nga autoritetet kompetente.

Fondet Pensionale dhe Siguruesit e Pensioneve do të konsiderohen në pajtueshmëri me rregullat e **shpërndarjes së investimeve** nëse kushtet në vijim janë plotësuar:

- Investimet e bëra janë në pajtueshmëri me afatet dhe kushtet që bëjnë pjesë në Deklaratën e tyre të Principeve të Investimeve të aprovuara nga BQK.
- Asetet e Fondit Pensional, ose kur aplikohet Siguruesit e Pensionit, janë mbajtur dhe ruajtur nga Kujdestari në pajtueshmëri me marrëveshjen e kujdestarisë së aseteve.
- Shuma e aseteve nuk tejkalon Pesëqind Mijë (500,000) Euro.
- Fondi Pensional ose Siguruesi i Pensionit ka dorëzuar në BQK një plan të pranueshëm për rritjen e shpërndarjes së investimeve të tij.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveç nëse është e theksuar ndryshe)

2.6 Asetet neto të Fondit 1

Vlera e asetëve neto të Fondit barazohet me total asetet minus total detyrimet e Fondit1.

2.7 Vlera e njësisë së llogaritjes

Vlera e njësisë së llogaritjes barazohet me vlerën e asetëve neto të Fondit të pjestuara nga numri total I njësisive të llogaritjes në datën e llogaritjes. Kjo formulë nuk aplikohet për ditën e parë të operacioneve kur vlera e njësisë së llogaritjes barazon me 100 Euro në pajtueshmëri me politikën e Fondit.

2.8 Të hyrat e interes

Të hyrat e interes përfshijnë të hyrat nga normat e kuponëve të obligacioneve dhe interesi mbi depozitat me afat. Të hyrat e interes janë regjistruar në baza akruale.

2.9 Tarifa e menaxhimit

Fondi është i obliguar të paguajë tarifën e menaxhimit Kompanisë në baza ditore. Tarifa vjetore e menaxhimit është 1.5 % të total asetëve të Fondit.

2.10 Shpenzimet për tarifat e transaksionit

Këto shpenzime lidhen me tarifën e paguar ndërmjetësuesve financiar (bankave dhe komisionerëve) që sigurojnë letra me vlerë të investimeve për Fondin I.

2.11 Fitimet/humbjet e realizuara

Fitimet/humbjet e realizuara dalin nga shitja e letrave me vlerë, nivelizimi i çmimeve kur letrat me vlerë anë siguar dhe kapitali i maturuar dhe interesi për letrat me vlerë janë siguar në prime ose zbritje. Këto fitime/humbje janë regjistruar në të ardhura ose shpenzime kur ato ndodhin.

2.12 Fitimet/humbjet e porealizuara

Fitimet/humbjet e porealizuara janë regjistruar si ndryshime ndërmjet kostot dhe vlerës reale të letrës me vlerë ose me koston e a ortizuar. Kur kapitali apo pjesë të kapitalit maturohen, si dhe kur letrat me vlerë shitet shuma e fitimit/humbjes së porealizuar është transferuar në fitimet/humbjet e realizuara për periudhën për të cilën flitet.

2.13 Amortizimi i zbritjes (diskontimit)/primi i letrës me vlerë

Amortizimi i zbritjes(diskontimit)/primi i letrës me vlerë është regjistruar përmes të ardhurave/shpenzimeve të shtyra dhe shpenzimeve/të ardhurave akruale. Ne momentin kur letra me vlerë është maturuar apo shitur, shuma e amortizuar është transferuar si fitim ose humbje e realizuar kapitale.

2.14 Fitimi/humbja e këmbimit në valutë të huaj

Transaksionet në valutën e huaj janë regjistruar në pajtueshmëri me normat e vlefshme të këmbimit në datën e transaksionit. Ndryshimet janë regjistruar në pasqyrën e të ardhurave si fitim/humbje.

2.15 Transaksionet me palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura janë definuar si ato palë të cilat kanë kontroll mbi njëra tjetrën ose kane ose që mund të kenë ndikim në vendimet financiare dhe operacionale të njëra tjetrës.

Palët e ndërlidhura te Fondit janë Prva Group PLC nga Ljubljana, Sllovenia dhe Korporata Dukagjini nga Peja, Republika e Kosovës, të cilët menaxhojnë dhe administrojnë Fondin I.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveç nëse është e theksuar ndryshe)

3 Instrumentet financiare sipas kategorisë

Vlerat bartëse të asetëve financiare dhe detyrimeve të Kompanisë siq janë siq janë njohur në datën e pasqyrave financiare nën rishikim mundën gjithashtu të kategorizohen siq vijon.

	Në vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	Huatë dhe të arkëtueshmet	Të-mbajtura-deri-në-maturitet	Totali
31 Dhjetor 2012				
Asetet				
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	-	101,046	-	101,046
Letrat me vlerë të mbajtura për tregëtim	196,768	-	-	196,768
Letrat me vlerë të-mbajtura-me-maturitet	-	1,046,881	3,122,642	4,169,523
Të arkëtueshme të tjera	-	387	-	387
	196,768	1,148,314	3,122,642	4,467,724
			Detyrime të tjera financiare me kosto te amortizuar	Totali
Detyrimet				
Detyrimet ndaj kompanisë	-	-	6,741	6,741
Të pagueshmet ndaj pjesëmarrësve pensional	-	-	-	-
Detyrime tjera	-	-	10,182	10,182
	-	-	16,923	16,923
	Me vlerë të drejtë nëpërmjet fitimit dhe humbjes	Huatë dhe të arkëtueshmet	Të mbajtura-deri-në-maturitet	Totali
31 Dhjetor 2011				
Asetet				
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	-	77,919	-	77,919
Letrat me vlerë të mbajtura për tregëtim	117,263	-	-	117,263
Letrat me vlerë të-mbajtura-me-maturitet	-	805,616	3,077,129	3,882,745
Të arkëtueshme të tjera	-	1,748	-	1,748
	117,263	885,283	3,077,129	4,079,675
			Detyrime të tjera financiare tek kosto e amortizuar	Totali
Detyrimet				
Detyrimet ndaj kompanisë	-	-	17,137	17,137
Të pagueshmet ndaj pjesëmarrësve pensional	-	-	16,806	16,806
Detyrime të tjera	-	-	182	182
	-	-	34,125	34,125

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveç nëse është e theksuar ndryshe)

4 Paraja dhe ekuivalentet e parasë

	2012	2011
Llogaria e kursimeve - Raiffeisen Bank	39,124	1,372
Llogaria e kujdestarisë - Nova Ljubljanska Banka d.d., NLB	35,856	4,314
Llogaria e kontributeve - NLB Kasabank	11,332	4,275
Llogaria e parasë së gatshme Raiffeisen bank	4,889	1,010
Llogaria rrjedhese - BKT	4,547	-
Llogaria e parasë së gatshme TEB	2,574	7
Llogaria e Bankës Ekonomike	1,142	428
Llogaria e kontributeve - Pro Credit Bank	954	7,352
Llogaria e pagesës së pensioneve - Banka Ekonomike	356	32,961
Llogaria e kontributeve - Banka Ekonomike	272	5,704
Llogaria e mbledhjes - Raiffeisen Bank	-	20,496
	101,046	77,919

5 Letrat me vlerë të mbajtura për tregëtim

	2012	2011
Letra me vlerë ekuiteti	176,283	105,118
Obligacionet Qeveritare	20,485	12,145
	196,768	117,263

Tabela ne vazhdim paraqet lëvizjen e letrave me vlerë të mbajtura për tregëtim gjatë vitit 2012 dhe 2011:

	Obligacionet Qeveritare	Letra me vlerë ekuiteti	Totali
Më 31 Dhjetor 2011	12,145	105,118	117,263
Shtesat	20,497	54,776	75,273
Heqjet	(12,145)		(12,145)
Ndryshimi në kursin valutor	-	(3,231)	(3,231)
Fitimi/humbja i porealizuar	(12)	19,620	19,608
Më 31 Dhjetor 2012	20,485	176,283	196,768
Më 31 Dhjetor 2010/ 01 Janar 2011	38,429	36,168	74,597
Shtesat	-	65,367	65,367
Heqjet	-	-	-
Ndryshimi neto në kursin valutor	-	7,469	7,469
Fitimi/humbja i porealizuar	(26,284)	(3,886)	(30,170)
Më 31 Dhjetor 2011	12,145	105,118	117,263

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
(Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveç nëse është e theksuar ndryshe)

6 Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturitet

Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturitet përbëhet tërësisht nga obligacionet dhe letrat me vlerë të borxhit të lëshuara nga kompanitë dhe bankat e huaja.

	2012	2011
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturitet	3,122,642	3,077,129
Depozitat në banka	962,600	753,600
Interesi i përlogaritur	84,281	52,016
Më 31 Dhjetor	4,169,523	3,882,745

Tabela në vazhdim paraqet lëvizjen e letrave me vlerë të mbajtura deri në maturitet për vitin 2012 dhe 2011:

	2012	2011
01 Janar	3,077,129	2,691,918
Shtesat	17,998	349,319
Maturuar	(65,528)	(50,571)
Amortizimi i diskontimit të letrave me vlerë me maturitet fiks	93,043	86,463
Më 31 Dhjetor	3,122,642	3,077,129

Depozitat në banka

	2012	2011
Banka Ekonomike e Kosovës	167,000	146,000
NLB Kasabank	185,000	155,000
Raiffeisen Bank	100,000	100,000
TEB –Turkish Enterprise Bank	185,000	145,000
Pro Credit Bank PCB	157,600	157,600
Banka Kombetare Tregtare BKT	168,000	50,000
Totali	962,600	753,600

Depozitat në banka fitojnë interes ne baza vjetore nga 4% deri 6.7%. Periudha e maturimit të tyre varion nga 1 deri në 4 vjet.

7 Detyrime të tjera

	2012	2011
Detyrimet për pensione	10,000	-
Detyrime të tjera	182	182
	10,182	182

Detyrimet për pension përfaqësojnë listën që nuk është marrë për ndarjen e kontributeve pensionale të paguara deri më 31 Dhjetor 2012.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
 Për vitin e përfunduar më 31 Dhjetor 2012
 (Të gjitha shumat janë shprehur në Euro, përveç nëse është e theksuar ndryshe)

8 Të hyrat nga interesi

	2012	2011
Të hyrat nga interesi i letrave me vlerë	99,840	93,376
Të hyrat nga interesi në depozita	48,937	45,494
Të hyrat nga interesi në llogari bankare	1,896	4,002
	150,673	142,872

9 Transaksionet me palët e ndërlidhura

Palët e ndërlidhura përfshijnë aksionarët kryesorë, bashkimet dhe entitetet nën pronësi të përbashkët, kontrollin dhe menaxhimin e Fondit, apo aktivitetet e të cilave Fondi ka kompetencën për ti kontrolluar.

Të gjitha transaksionet e Fondit me palët e ndërlidhura dalin nga rrjedha normale e biznesit dhe vlera e tyre nuk është materialisht e ndryshe nga afatet dhe kushtet që do të i zotëronin në transaksione të vullnetit të lirë. Të gjitha transaksionet e palëve të ndërlidhura dhe balancet i referohen Kompanisë, FSKP-së dhe janë si në vazhdim:

	2012	2011
Shpenzimet për tarifën e menaxhimit	63,715	57,948
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	6,741	17,137

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

10 Menaxhimi i riskut financiar

Aktivitetet e Fondit e ekspozojnë atë ndaj disa risqeve financiare dhe këto aktivitetet përfshijnë analizat, vlerësimin, pranimin dhe menaxhimin e risqëve. Synimi i Fondit është që të arrijë një balanc të përshtatshëm ndërmjet riskut dhe kthimit dhe të minimizojë kundër efektet e mundshme mbi performancën financiare të Fondit.

Politikat e Fondit për menaxhimin e riskut janë dizajnuar për të identifikuar dhe analizuar këto risqe, për të vënë limitet e duhura dhe kontrollin e riskut, dhe për të monitoruar risqet dhe zbatimin e limiteve me anë të mjeteve të sistemit informative të besueshëm dhe modern. Menaxhmenti i Fondit rregullisht rishikon politikat dhe sistemet e menaxhimit të riskut për të reflektuar ndryshimet në tregje, produkte dhe praktikatat më të mira që dalin.

Menaxhimi i riskut bartet nga Departamenti i Menaxhimit të Riskut nën politikat e aprovuara nga Kompania. Ky departament identifikon dhe vlerëson riskun financiar në bashkpunim të ngushtë me njësitë operative të Fondit. Fondi ofron parime të shkruara për menaxhimin e përgjithshëm të riskut, si dhe politika të shkruara që mbulojnë fusha specifike, si risku i këmbimeve të huaja, risku i normës së interesit dhe risku kreditor.

11.1 Risku kreditor

Fondi merr pjesë në ekspozimin ndaj riskut kreditor, i cili është një rrezik që një palë e kundërt do të shkaktojë humbje për Fondin duke dështuar në shlyerjen e obligimit. Risku kreditor është risku më i rëndësishëm për aktivitetet biznesore të Fondit. Prandaj, menaxhmenti i Fondit me kujdes menaxhon ekspozimin ndaj riskut kreditor. Fondi duhet të jetë në përputhje me rregullat e BQK-së përsa i përket llojeve dhe shumave të investimeve në asetet financiare.

	2012	2011
Ekspozimi maksimal ndaj rrezikut të kredisë		
Letrat me vlerë të mbajtura për tregëtim		
Letrat me vlerë të ekuitetit	176,283	105,118
Interesi i përllogaritur	20,485	12,145
	196,768	117,263
Letrat me vlerë të mbajtura deri maturitet		
Depozitat në banka	962,600	753,600
Obligacionet qeveritare	632,607	641,440
Obligacionet e korporatave	2,490,035	2,435,689
Interesi i përllogaritur	84,281	52,016
	4,169,523	3,882,745
Të arkëtueshmet tjera	387	1,748
	4,366,678	4,001,756

11.2 Rreziqet e tregut

Fondi është i ekspozuar ndaj risqeve të tregut. Risqet e tregut dalin nga pozicioni i hapur i Fondit ndaj efektit të luhatjeve në nivelin dominues të normave të tregut të interesit, si dhe nga efekti i luhatjeve në normat e këmbimit të valutave të huaja. Menaxhmenti i Fondit vendos limitet e vlerës së riskut që mund të pranohet, i cili është kryesisht i bazuar në monitorim të përditshëm.

Risku i normës së interesit

Fondi merr përsipër ekspozimin ndaj efekteve të luhatjeve në nivelet dominuese të tregut të normave të interesit mbi pozicionin e tij financiar dhe rrjedhë të parasë.

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risqet e tregut (vazhdim)

Tabela e mëposhtme analizon asetet dhe detyrimet e Fondit në grupime relevante të maturitetit duke u bazuar në periudhën e mbetur në datën e bilancit të gjendjes deri te data e maturitetit të kontraktuar, për 31 Dhjetor 2012 dhe 2011 (në Euro).

31 Dhjetor 2012	Që bartin interes				Më shume se 5 vite	Që nuk bartin interes	Totali
	Më pak se 1 muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Nga 1 deri 5 vite			
Asetet							
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	101,046	-	-	-	-	-	101,046
Letrat me vlerë të mbajtura për tregëtim	20,485	-	-	-	-	176,283	196,768
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturitet	-	124,230	250,505	2,847,735	862,772	84,281	4,169,523
Të arkëtueshmet tjera	-	-	-	-	-	387	387
	121,531	124,230	250,505	2,847,735	862,772	260,951	4,467,724
Detyrimet							
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	-	-	-	-	-	6,741	6,741
Detyrime të tjera	-	-	-	-	-	10,183	10,182
						16,924	16,923
Hapësira e riskut të interest neto	121,531	124,230	250,505	2,847,735	862,772	244,028	4,450,800
31 Dhjetor 2011							
Totali i asetëve financiare	90,064	171,666	29,313	1,867,803	1,761,947	158,882	4,079,675
Totali i detyrimeve financiare	-	-	-	-	-	34,125	34,125
	90,064	171,666	29,313	1,867,803	1,761,947	124,757	4,045,550

Risku i valutës së huaj

Më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011, Fondi është ekspozuar riskut duke marrë parasysh efektet nga rrjedha e parasë të normës së nivelit të këmbimit valutator. Tabelat në vijim përmbledhin pozicionin e riskut valutator të asetëve monetare dhe detyrimeve të Fondit më 31 Dhjetor 2012 dhe 2011 (në Euro):

31 Dhjetor 2012	Në EUR	Në USD	Valuta të tjera	Totali
Asetet				
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	100,023	1,023	-	101,046
Letrat me vlerë të mbajtura për tregëtim	77,832	118,936	-	196,768
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturitet	4,169,523	-	-	4,169,523
Të arkëtueshmet tjera	387	-	-	387
Total asete	4,347,765	119,959		4,467,724
Detyrime				
Detyrime për tarifën e menaxhimit	6,741	-	-	6,741
Detyrime të tjera	10,183	-	-	10,183
Totali i detyrimeve	16,924	-	-	16,924
Risku i valutës së huaj neto	4,330,841	119,959	-	4,450,800
31 Dhjetor 2011				
Totali i asetëve financiare	3,989,007	90,668	-	4,079,675
Totali i detyrimeve financiare	34,125	-	-	34,125
Risku i valutës së huaj neto	3,954,882	90,668	-	4,045,550

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

11.3 Risku i likuiditetit

Politika e Fondit 1 është të investojë asetet në instrumentet e larta likuide financiare në tregje të ndryshme kapitale në përputhshmëri me kufizimet e përshkruara nga Ligji dhe Rregulloret. Gjatë procesit të krijimit të portfolios së Fondit, duke u munduar të sigurojmë likuiditet të lartë, asetet e Fondit janë investuar në letra me vlerë të karakterizuara me mundësinë e shkëmbimit të shpejtë në para dhe ekuivalente të parasë.

Tabela në vazhdim analizon asetet dhe detyrimet e Fondit në maturitetet relevant duke u bazuar në periudhën e mbetur në datën e bilancit të gjendjes deri në datën e kontraktuar të maturitetit (në Euro).

31 Dhjetor 2012	Më pak se një muaj	Nga 1 deri 3 muaj	Nga 3 deri 12 muaj	Nga 1 deri 5 vjet	Më shumë se 5 vjet	Totali
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	101,046	-	-	-	-	101,046
Letrat me vlerë të gatshme për tregëtim	196,768	-	-	-	-	196,768
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturitet	84,281	124,230	250,505	2,847,735	862,772	4,169,523
Të arkëtueshmet tjera	387	-	-	-	-	387
	382,482	124,230	250,505	2,847,735	862,772	4,467,724
<i>Detyrimet</i>						
Detyrimet për tarifën e menaxhimit	6,741	-	-	-	-	6,741
Detyrimet tjera	10,183	-	-	-	-	10,183
	16,924	-	-	-	-	16,924
Hapësira likuide neto	365,559	124,230	250,505	2,847,735	862,772	4,450,800
31 Dhjetor 2011						
Totali i aseteve financiare	248,946	-	-	1,955,900	1,874,829	4,079,675
Totali i detyrimeve financiare	34,125	-	-	-	-	34,125
Hapësira likuide neto	214,821	-	-	1,955,900	1,874,829	4,045,550

11.4 Vlerësimi i vlerës së drejtë

Vlera e drejtë përfaqëson shumën me të cilën një asset mund të zëvendësohet ose një detyrim të shlyhet në transaksion duar lirë. Vlera e drejtë është bazuar në supozimet e menaxhmentit sipas profilit të asetit dhe bazës së detyrimit.

Instrumentet financiare të prezentuara me vlerën e drejtë

Asetet financiare të matura sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e pozicionit financiar në përputhshmëri me hierarkinë e vlerës së drejtë janë të paraqitura në tabelën vijuese. Kjo hierarki mbledh asetet financiare dhe detyrimet në tre nivele që bazohen në rëndësinë e të dhënave të ardhura të përdorura gjatë matjes së vlerës së drejtë të aseteve financiare:

- **Niveli 1:** çmimet e kuotuar (jo të rregulluara) në tregjet aktive për asetet identike ose detyrimet;
- **Niveli2:** të dhëna hyrëse të tjera, përveç prej, çmimeve të kuotuar, të përfshira në nivelin 1 që janë të gatshme për vëzhgim të asetit ose të detyrimit, direkt (p.sh. si çmime), ose indirekt (p.sh. të bëra nga çmimet) dhe
- **Niveli3:** të dhënat hyrëse në asset ose detyrim që nuk janë të bazuara në të dhëna të gatshme për vëzhgim të tregut

Shenimet e pasqyrave financiare (vazhdim)
Menaxhimi i riskut financiar (vazhdim)

Risku i likuiditetit (vazhdim)

Asetet financiare që janë regjistruara sipas vlerës së drejtë në pasqyrën e Fondit 1 të aseteve neto janë mbledhur sipas nivelit të hierarkisë së vlerës reale, siq vijon (në Euro).

	Niveli 1	Niveli 2	Niveli 3	Totali
Asetet				
Letrat me vlerë të mbajtura për tregëtim	196,768	-	-	196,768
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturitet	4,169,523	-	-	4,169,523

Instrumentet financiare që nuk janë prezentuar në vlerë të drejtë

Tabela në vijim përmbledh vlerat bartëse dhe vlerën e drejtë të atyre aseteve financiare dhe detyrimeve që nuk janë prezentuar në bilancin e gjendjes tek vlera e drejtë.

	Vlera bartëse		Vlera e drejtë	
	2012	2011	2012	2011
Asetet				
Paraja dhe ekuivalentet e parasë	101,046	77,919	101,046	77,919
Letrat me vlerë të mbajtura deri në maturitet	4,169,523	3,882,745	4,169,523	3,882,745
Të arkëtueshme të tjera	387	1,748	387	1,748
Total assets	4,720,956	3,962,412	4,720,956	3,962,412

Detyrimet

Detyrimet për tarifën e menaxhimit dhe detyrime të tjera

	16,924	34,125	16,924	34,125
Total detyrime	16,924	34,125	16,924	34,125

Vlera e drejtë e instrumenteve financiare të tregtuara në tregje aktive (siq janë letrat me vlerë të tregtueshme dhe të gatshme për shitje) është e bazuar në çmimet e kuotuar të tregut në datën e bilancit. Çmimi i kuotuar i tregut i përdorur për asetet financiare të mbajtura nga Fondi është çmimi aktual i ofertimit.

Vlera reale e instrumenteve financiare që nuk janë tregtuar në tregje aktive është përcaktuar duke përdorur teknikat e vlerësimit.

Vlerat bartëse minus provisioni për dëmtimin e të arkëtueshmeve tregtare si dhe vlera bartëse e të pagueshmeve supozohet se përfaqsojnë vlerat e tyre reale. Vlera reale e detyrimeve financiare pëe qëllime të shpalosjes është vlerësuar duke zbritur rrjedhat e ardhshme të parasë së kontraktuar në normën e interes aktuale në treg që është në dispozicion të fondit për instrumente të ngjashme financiare.